

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësit e institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Nëntor, 2023

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, Shqipëri dhe ANAC, Itali lidhin marrëveshje bashkëpunimi

13.11.2023: Ministri i Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, në Shqipëri, Z.Ulsi Manja, formalizoi një hap të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit, duke nënshkruar në Romë, Itali, një marrëveshje bashkëpunimi me presidentin e Agjencisë Kombëtare Italiane Kundër Korrupsionit - ANAC, Z.Giuseppe Busia. Ky zhvillim në luftën kundër korrupsionit, materializuar përmes marrëveshjes dypalëshe mes Shqipërisë dhe Italisë, shënon një hap përpara në forcimin e strukturave antikorrupsion. Thellimi i bashkëpunimit midis Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion në Shqipëri dhe ANAC në Itali, konsolidon përpjekjet për të zhvilluar integritetin në të gjitha përpjekjet institucionale. Fokusi i bashkëpunimit përfshin parandalimin e korrupsionit në veprimtaritë institucionale kundër korrupsionit në nivel administrativ. Marrëveshja është një shembull i ndërthurjes së burimeve dhe ekspertizës për të përballuar sfidat komplekse të korrupsionit me krijimin e një mjedisi të përbashkët duke integruar praktikën dhe përvojat e dy vendeve për të adresuar sfidat e përbashkëta drejt objektivit për më shumë veprim në kuadër shtetit të së drejtës dhe sundimit të ligjit. Kjo marrëveshje do t'i shërbejë gjithashtu në të ardhmen, forcimit të kapaciteteve antikorrupsion në Shqipëri, për ta shndërruar Drejtorinë e Përgjithshme Antikorrupsion në një agjenci në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Marrëveshja lidhet pa afat kohor dhe është e para marrëveshje bashkëpunimi institucionale me një vend anëtar në Bashkimin Evropian.



Lufta kundër korrupsionit dhe integriteti në biznes ulin bashkë në një forum diskutimi Ministrinë e Drejtësisë dhe FIAA

17.11.2023: Ministria e Drejtësisë dhe Shoqata e Investimeve të Huaja në Shqipëri - FIAA, zhvilluan një forum të përbashkët diskutimi. Ekspertë kundër korrupsionit, hulumtues, hetues administrativë dhe përfaqësues të bizneseve të huaja në Shqipëri u mbledhën bashkë për të shkëmbyer pikëpamje dhe përvoja. Kjo nismë shënoi një hap të rëndësishëm drejt thellimit të bashkëpunimit ndërmjet sektorit privat dhe institucioneve publike kundër korrupsionit. Përvojat dhe praktikën më të mira të punës, nga bizneset e huaja u ndanë, me fokusin për të forcuar integritetin në administratë dhe përcjellë modelet e tyre të suksesit dhe etikës. Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, Ministri i Drejtësisë Ulsi Manja, konfirmoi prioritetin për përmirësimin e klimës së biznesit si parim i luftës kundër korrupsionit. Reforma për heqjen e burokracive dhe zvogëlimin e barrierave e njohur si reforma e derregullimit, pritet të mbështesë një klimë të favorshme për investime të reja në Shqipëri. Palët pjesëmarrëse si punonjësit, aksionerët apo partnerët e biznesit, u angazhuan në një shkëmbim të sinqertë dhe të hapur mbi masat e disponueshme për parandalimin dhe reagimin ndaj korrupsionit. Komunikimi me biznesin për të rritur numrin e rasteve që mund të denoncohen në Drejtorinë e Përgjithshme Antikorrupsion dhe programimi i masave për më shumë integritet në sektorin privat ishin tematika e dy paneleve të diskutimit nga ekspertët dhe profesionistët e pranishëm. Shkëmbimi i praktikave më të mira nga disa kompani ndërkombëtare, me një histori të gjatë në promovimin e integritetit, antikorrupsionit, vendimarrjes etike u sollën si shembull i përpjekjeve për të forcuar rolin e rritur besimit e investitorëve në potencialin e Shqipërisë si destinacion i larmishëm dhe i integruar në tregun ndërkombëtar.



Nëntor 2023: Struktura antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë jep masa dhe rekomandime për organet e administratës publike


01-30.11.2023: Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion, ka vijuar me verifikimin dhe hetimin administrativ të rasteve të dyshuara të korrupsionit, duke prodhuar rezultate konkrete edhe gjatë muajit nëntor. Masa dhe veprime mbështetur në statistikën e punës, japin rezultate domethënëse dhe një historik solid në përpjekjet e përbashkëta për të ndërtuar një shoqëri më të drejtë dhe transparente. Në analizën e rezultateve të punës për muajin nëntor 2023, evidentohen se nga totali prej 24 ankesash dhe denoncimesh, janë ndërmarrë 20 masa për fillimin e ecurisë disiplinore për shkelje të rregullave të punonjësve publikë, si dhe janë ofruar 3 rekomandime për të përmirësuar dhe unifikuar praktikën institucionale. Përveç hetimeve administrative, problematika të hasura më shpesh vijojnë të jenë ato në fushën e pronave, shërbimeve me publikun në tatime, shërbimi i mbrojtjes për territorin, shërbimet e punës, ato shoqërore dhe shëndetësore apo fusha e sigurimit të cilësisë ushqimore. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në bashkëpunim me Rrjetin e Koordinatorëve Antikorrupsion, vijon punën me trajtimin e të gjitha ankesave nga denoncimet e qytetarëve, në mënyrë që të japë zgjidhje konkrete për problematikën e hasura si dhe të zvogëlojë riskun për praktika të parregullta. Ky proces po lehtësohet ndjeshëm edhe nga Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Denoncimeve mbi Rekordet Korruptive, i cili po mundëson trajtimin në kohë dhe me efikasitet të denoncimeve qytetare në adresën e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, në vend.

Denonconi raste dhe praktika abuzive, në adresën: koordinatoriak@drejtesia.gov.al



Nis hartimi i ligjit për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve

22.11.2023: Standardizimit institucional në luftën kundër korrupsionit po i shtohet edhe një institucion i ri. Zyra për Rikuperimin e Aseteve – ZRA, një institucion multidisiplinor, ligjzbatues dhe koordinues do të ngrihet së afërmi dhe do të funksionojë dhe organizohet me një ligj të posaçëm. Zyra për Rikuperimin e Aseteve do të jetë pika qendrore kombëtare e kontaktit të Shqipërisë, për tu marrë me procesin e gjurmimit dhe identifikimit të produkteve të krimit dhe pasurive të tjera të lidhura me krimin, të cilat mund të bëhen objekt i një urdhri ngrirjeje, sekuestrimi ose konfiskimi të bërë nga gjykata gjatë proceseve penale ose në një proces civil gjyqësor. Zyra për Rikuperimin e Aseteve do të ngrihet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Zyra për Rikuperimin e Aseteve do të jetë porta hyrëse dhe dalje e informacionit për gjurmimin dhe identifikimin e të ardhurave nga krimi, edhe në rastet kur dyshohet se është i kryer jashtë juridiksionit të organeve shqiptare dhe do të mbështesë zbatimin e urdhërave vendas dhe ndërkombëtarë për sekuestrimin, ngrirjen dhe konfiskimin e asetëve. Propozimi për ngritjen e ZRA vjen si një propozim i Komisionit Evropian dhe vendosja e saj pranë Policisë së Shtetit u mbështet nga Ministria e Drejtësisë. Projektligji për ZRA po hartohet nga Ministria e Brendshme me asistencën e Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë. Projektligji po konsultohet me Ministrinë e Drejtësisë dhe organin e prokurorisë.











Kursi online HELP- Njohje me Parandalimin e Korrupsionit, vjen në gjuhën shqipe

23.11.2023: Stafet politike pranë kabineteve ministore do t'i nënshtrohen së shpejti trajnimeve dhe informimit periodik e këshillimit konfidencial për integritetin dhe kuadrin kundër korrupsionit. Ministria e Drejtësisë po koordinon kryerjen e një procesi informimi për stafet politike (këshilltarët) pranë ministrave (rekomandimi 5 i GRECO për Shqipërinë) duke pasuruar procesin edhe me kursin online të Këshillit të Evropës, HELP: Njohje me Parandalimin e Korrupsionit. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike – ASPA është duke përfutur asistencën teknike të Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë për të shtuar në kurrikulën e trajnimeve antikorrupsioni, këtë kurs trajnimi duke inkorporuar në të edhe kuadrin rregullator vendas, në zbatim. Dispozitat mbi kodin etik ministror, ligji për konfliktin e interesit, rregullat e pas-punësimit, dhuratat dhe deklarimi i pasurive, e drejta e informimit, lobimi, financat e partive politike, sinjalizimi, risku i korrupsionit në prokurimet publike dhe auditimi i brendshëm janë komponentët e kursit HELP, i cili tashmë do të vijë edhe në gjuhën shqipe dhe përfundim të të cilit pjesëmarrësit do të certifikohen. ASPA do të ketë pronësinë e përdorimit të këtij kursi, që do të ofrohet në vijim edhe për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë. Nisma është një vlerë e shtuar për administratën shqiptare (stafet politike), njësinë trajnuese, ekspertët shqiptarë të fushës, bashkëpunimin me partnerët e huaj në vendosjen e standardeve.



Java e Integritetit, edicioni V, aktivitete për 10 ditë në muajin dhjetor

01-30.11.2023: Ministria e Drejtësisë mbyll përgatitjet për aktivitetet e fushatës më të madhe vjetore të ndërgjegjësimit, Java e Integritetit, Edicioni V. Edukimi i publikut për luftën kundër korrupsionit, bashkëpunimi me biznesin për vendosjen e kulturës së integritetit në sektorin privat dhe partneriteti i denoncimit të korrupsionit si dhe promovimi i dy udhëzuesve për hetimin e rasteve të krimit ekonomik dhe të korrupsionit janë disa prej aktiviteteve të këtij edicioni. Java e Integritetit do të zhvillohet intensivisht prej 4-15 dhjetor 2023 me një varietet aktiviteteve me fokus grupe të ndryshme interesi. Ministria e Drejtësisë do ta nisë këtë edicion me nënshkrimin e projekti bashkëpunimi në fushën e arsimit për informimin e të rinjve 15-vjeçarë për korrupsionin, për të vijuar me promovimin e botimeve praktike për profesionistët e gjyqësorit në hetimin e rasteve të korrupsionit. Java e Integritetit V, do të ulë në një tryezë ekspertët antikorrupsion të qeverisë me përfaqësuesit e biznesit dhe për ta mbyllur me informimin dhe ndërgjegjësimin e këshilltarëve politikë për çështje të parandalimit të korrupsionit dhe raste për diskutim për etikën dhe integritetin. Ministria e Drejtësisë do të bashkohet gjithashtu edhe aktiviteteve të partnerëve të edicionit V, për të informuar mbi rolin e saj themelor në ecurinë e integritetit evropian të vendit. Qëndroni të informuar për çdo ditë me aktivitetet e Javës së Integritetit në profilet sociale të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, në Facebook, LinkedIn, Twitter, etj.



Bulevardi "Zog I-rë", Tiranë



<http://www.drejtesia.gov.al>



infoak@drejtesia.gov.al

